



Q.1c r3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALMA M. BURGAJ  
ADRESA NR.8, RR. E DIBRES, NR.403  
TEL: 672003856

## VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 2447

Nr. koleksioni: 1296

Tirane më 11/03/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050690147342012



DATE 11/03/2021  
NR REP 2447  
NR KOL 1296



A2021050690147342012

LËSHIMI I DËSHMISË  
SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, më datë 11/03/2021(dy mijë e njetë e nje) , para meje Notere ALMA M. BURGAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.8, RR. E DIBRES, NR.403, u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT:**

Suzana Kruja, atësia Fadil, amësia Mide, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Gjon Buzuku Nr.39; Njësia Administrative Nr. 8; 0000; Tiranë, lindur më 14/01/1964, gjendja civile “e ve”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035880642 dhe nr. personal G451141151, .

**OBJEKTI:** Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin Besnik Kruja.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noteri/ja kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë, përkatësisht Notere ALMA M. BURGAJ, me zyrë Noterie në Tirane, NR.8, RR. E DIBRES, NR.403, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

**V Ë R E J**

Se kërkuesja **Suzana Kruja** është bashkeshortja e trashëgimlënësit të ndjerit **Besnik Kruja** ndaj në bazë të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, ai ka interes të ligjshëm në këtë kërkim, pra legjitimohet të paraqesi kërkimin para noterit.

Gjithashtu zyra ime noteriale në Tiranë, ne baze te ligjit 110/2018 date 20.12.2018 i ndryshuar, ka kompetencën tokësore për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit rezulton të ketë genë në Tiranë.

Në lidhje me pretendimin e kërkueses, para noterit u shtruan për zgjidhje këto çështje: a) përcaktimi i trashëgimtarëve të trashëgimlënësit së kërkuar nga kërkuesja dhe b) pjesët takuese të secilit prej tyre.

Për të zgjidhur këto probleme, une noterja i referohem nenit 318 të Kodit Civil, i cili në lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve të trashëgimlënësit dhe pjesët takuese të secilit, bën të zbatueshëm ligjin e kohës se çeljes së trashëgimisë, referuar rregullimit ligjor në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, rezulton e provuar se: më datë 10/02/2021 ka vdekur në Tiranë, trashëgimlënësi **Besnik Kruja**, me atësi Sulejman dhe amësi Ikbale me datëlindje 29/05/1960 lindur në Tirane fakt që vërtetohet nga çertifikata e vdekjes lëshuar me datë 02/03/2021 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake Nr.8, Tiranë.



A2021050690147342012

Në rastin konkret ligji i zbatueshëm është ligji nr.7850 datë 29.7.1994 « Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë », dhe meqenëse nga hetimi nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë disponuar pasurinë e tij me testament, në bazë të nenit 317 të Kodit Civil do të zbatohet trashëgimia ligjore.

Neni 361 i Kodit Civil aktual, përcakton në paragrafin e parë të tij si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshortin dhe fëmijët me formulimin: «*Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta.*

Nga çertifikata e përbërjes familjare lëshuar me datë 01/03/2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake nr.8 Tirane, rezulton që trashëgimlënësi **Besnik Kruja**, ka qenë i martuar me shtetasen **Suzana Kruja**, atësia Fadil dhe amësia Mide me datëlindje 14/01/1964, lindur në Tirane banuese Tiranë, me gjendje civile e ve, me shtetësi shqiptare, me nr.personal G45114115I dhe nga martesja e tyre kanë patur **2 fëmijë**, shtetasit: **Olti Kruja**, atësia Besnik amësia Suzana, me datelindje 10/04/1989, lindur dhe banues ne Tirane, me numer personal I90410091M, **Suela Kruja**, atësia Besnik dhe amësia Suzana me datelindje 01/09/1991, lindur dhe banuese ne Tirane, me numer personal J15901074S.

Nga i gjithë dokumentacioni i administruar nga ana ime si notere rezulton se në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit që shënon dhe momentin e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë të gjithë personat e mësipërm kanë qenë gjallë; si të tillë ata thirren si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit **Besnik Kruja**.

Nga hetimi nuk rezulton që ndonjë nga trashëgimtarët e mësipërm të ketë hequr dorë nga trashëgimia, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykate, apo të jetë përjashtuar nga trashëgimia. Nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë pasur fëmijë të tjerë jashtë martese, apo të birësuar.

Kërkesja me deklaroi se nuk ka trashëgimtarë të tjere ligjorë, përveç atyre të pasqyruar në çertifikatat e trungut familjar dhe të pasqyruar në çertifikatat personale të depozituara prej saj.

Për sa më lart, trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit **Besnik Kruja** janë **bashkeshortja dhe fëmijet: Suzana Kruja – bashkeshortja, Olti Kruja – i biri, Suela Kruja – e bija**, të cilët e trashëgojnë trashëgimlënësin në 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore dhe mbartin detyrimet e saj në të njëjtën masë.

#### PËR KËTO ARSYE

Une notere Alma Burgaj, në bazë të nenit 306 të Kodit të Procedurës Civile

#### VENDOSA

- Pranimin e kërkesës.
- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit **Besnik Kruja**, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë:

- |                        |   |
|------------------------|---|
| 1. <b>Suzana Kruja</b> | (bashkëshortja e trashëgimlënësit) 1/3 (një të tretën pjesë); |
| 2. <b>Olti Kruja</b>   | (i biri i trashëgimlënësit) 1/3 (një të tretën pjesë);        |
| 3. <b>Suela Kruja</b>  | (e bija e trashëgimlënësit) 1/3 (një të tretën pjesë).        |

të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga 1/3 (një të tretën) pjesë të pasurisë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënësit.

- 2 Kërkesja mori dijëni dhe iu sqarua nga Noterja detyrimi ligjor për depozitim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.
- 3 Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të



A2021050690147342012

cënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 “Për Noterinë”. Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese. Bashkëlidhur certifikata e martesës nr. akti nga Akti i martesës lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Tiranë datë 23.04.2019, referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

2. Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkuessit.
6. Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 6 (gjashtë) fletë dhe lëshohet në kopje origjinalë nga të cilët, njëri depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkuessit për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pasuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.
7. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.
8. Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

*Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Tirane sot me date 11/02/2021*

**NOTER**  
ALMA M. BURGAI



